



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 14668 Prot

Lezhë, më 30/08 /2022

VENDIM

Nr. 95, Datë 29, 08, 2022

Për përdorimin e Fondit të Kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e përdorimit të Fondit të Kontigjencës në shumën 60,000 lekë, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022, për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

- Pakësohet : Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.609 për shumën 60,000 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.10430, Kap.01, Art.606 për shumën 60,000 lekë, fond i cili do të përdoret për dhënie ndihmë financiare të 2 familjeve për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të varrimit të të ndjerëve Loro Xhanaj dhe Lumnije Osmani.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË

SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 624/1 Prot.

Lezhë , më 01.09 2022

L e n d a : Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në ligjin nr. 107/2016, "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pika 2, gërma b, ligjin nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 54, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 95, datë 29.08.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për përdorim të fondit të kontigjencës për mbulimin e shpenzimeve të papashikuara në buxhetin e vitit 2022".

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

